



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

**Monitorimi
i të Drejtës për**

TUBIME PAQËSORE

**Raporti
për Shqipërinë
2016-2017**

Monitorimi i të Drejtës për Tubime Paqësore

Raporti për Shqipërinë

2016-2017

Autorë: Klotilda Kosta, Anora Topi dhe Kostandina Keruti (Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim)

Dhjetor 2017

Copyright © 2017 nga Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës dhe Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.



Ky raport financohet tërësisht nga Agjensia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA). SIDA jo domosdoshmërisht ndan mendimet e shprehura në përmbajtje të këtij raporti. Autori mban përgjegjësinë e vetme për përmbajtjen.

Ky studim u krye si pjesë e projektit rajonal "Monitorimi i të drejtës për tubime paqësore", i menaxhuar nga Qendra Evropiane për Ligjin Jo-fitimprurës (ECNL). Projekti është bërë i mundur nga Qendra Ndërkombëtare për Ligjin jofitimprurës (ICNL) përmes Iniciativës Hapësinore Qytetare.

Përshkrim i shkurtër i Iniciativës

Vitet e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe të rajonit të Partneritetit Lindor ka një rritje të numrit të protestave dhe intensitetit të tyre, e po ashtu edhe shkeljeve të lirive dhe të drejtave themelore lidhur me organizimin e tubimeve. Për të siguruar që të drejtat e lirisë së tubimit të kuptohen më mirë dhe për të fuqizuar përpjekjet advokuese, Qendra Evropiane për Ligjin Jofitimprurës (ECNL) punon me ekspertë vendorë nga nëntë vende (Shqipëri, Armeni, Bjellorusi, Bosnje dhe Herzegovinë, Maqedoni, Moldavi, Mali i Zi, Kosovë, Serbi) në vlerësimin e mjedisit ekzistues për tubimet në vendet e tyre përkatëse.

Ky vlerësim është një përmbledhje e shkurtër e çështjeve aktuale dhe zhvillimeve të fundit lidhur me lirinë e tubimit në Shqipëri.

Përmbajtja

Përmbledhje	3
Kuadri Ligjor	5
Vështrim mbi të Drejtën për Tubime Paqësore në 2016-2017	12
Kuadri Ligjor dhe Zbatimi.....	12
Policimi i Tubimeve.....	14
Media dhe Tubimet	17
Media Sociale dhe Tubimet.....	18
Përgjegjësia e Organizatorëve.....	19
Ndalimet dhe Ndjekjet Penale	21
Llogaridhënia	23
Vlerësim i Përgjithshëm	24
Rekomandime	25

PËRMBLEDHJE

Metodologjia

Përgatitja e këtij raporti u realizua gjatë muajve shtator - tetor 2017. Qëllimi i përgjithshëm ishte mbledhja e informacionit mbi kuadrin ligjor si dhe raste të zbatimit në praktikë, ilustruara me ngjarje konkrete mbi të drejtën e tubimeve në Shqipëri, duke theksuar progresin apo regresin në legjislacion dhe në zbatimin e tij. Partnerët Shqipëri mblodhi informacion nga hulumtimet, duke përfshirë rishikimin e legjislacionit dhe shqyrtimin e raporteve nga organizatat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe artikuj të ndryshëm në media. Gjithashtu, një pyetësor i strukturuar u përgatit për të vlerësuar praktikën nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) dhe grupet e qytetarëve të cilët kanë organizuar dhe/ose kanë marrë pjesë në një tubim. Bazuar në përgjigjet e tyre, Partnerët Shqipëri (PA) zhvilloi intervista të thelluara për të marrë informacion të detajuar dhe sqarime mbi këtë çështje.

Në Shqipëri nuk ka të dhëna apo statistika për tubimet të publikuara nga institucionet shtetërore të përfshira në faza të ndryshme të tubimeve. Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave, Partnerët Shqipëri dërgoi kërkesa zyrtare tek Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Avokati i Popullit, Bashkia e Tiranës dhe Gjykata Administrative për të mbledhur informacion mbi rolin dhe llogaridhënien e këtyre institucioneve lidhur me organizimin e tubimeve.

Gjetjet kryesore

Pesë gjetjet kryesore të identifikuar përmes vlerësimit të së drejtës për tubime të lira në Shqipëri renditen si më poshtë:

1. Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri është kryesisht në përputhje me standardet evropiane. Vendi ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, mbetet e nevojshme përmisrësimi i kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij në praktikë për të siguruar më tej lirinë e tubimit paqësor në Shqipëri.
2. Ka konfuzion në kuadrin ligjor për organizimin e tubimeve në sheshe dhe në vendkalime publike. Ndërsa në Ligjin për Tubimet parashikohet se organizatorët

duhet të **njoftojnë** me shkrim Policinë e Shtetit, në Kodin Penal organizimi i tubimeve pa **leje** nga organi kompetent përbën kundravajtje penale.

3. Tubimet spontane pa njoftim paraprak tek autoritetet publike dhe kundërprotestat nuk njihen në ligjin për tubimet. Ligji është gjithashtu shumë i paqartë sa i takon procedurës së ankimimit dhe apelimit të vendimeve të autoriteteve shtetërore. Nuk jep asnjë udhëzim se si dhe kur duhet të bëhet ankimi dhe/apo apelimi, dhe nuk tregon se cili institucion (Autoritet gjykues) do ta shqyrtojë atë.
4. Pavarësisht rasteve sporadike të shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e Policisë së Shtetit të raportuara gjatë disa protestave në vend, ka përmirësime në administrimin e tyre, ruajtjen e rendit publik dhe respektimin e lirisë për tubime paqësore.
5. Ka komunikim të kufizuar ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatorëve para tubimeve, për të krijuar mirëkuptim të ndërsjellë, për të shmangur përplasjet e panevojshme dhe për të parandaluar çdo incident gjatë tubimeve.

KUADRI LIGJOR

Në Shqipëri, liria e tubimit është një e drejtë kushtetuese e rregulluar në Nenin 46 pika 1: *"Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm"* dhe Nenin 47 pikat 1 dhe 2: *"Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe pjesëmarrja në to është e garantuar. Tubimet paqësore në sheshe dhe në vende të kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj"*.

Ligji primar që rregullon lirinë e tubimit është Ligji nr. 8773, datë 23.4.2001 "Për Tubimet", në bazë të të cilit çdo person ka të drejtë të organizojë dhe marrë pjesë në tubimet paqësore¹. Ligji siguron lirinë e tubimit paqësor për të gjithë pa asnjë përjashtim², kjo në përputhje me direktivat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR). Ligje të tjera që rregullojnë organizimin e tubimeve janë: Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" dhe Ligji nr.108 / 2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar.

Sipas Nenit 2, pika 5 e ligjit, me termin "tubime" kuptohen grumbullimet, manifestimet, mbledhjet dhe parakalimet me karakter paqësor dhe pa armë, në të cilat një grup personash shprehin kërkesat dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar dhe përfshin edhe tubimet urgjente.

Në varësi të vendit ku zhvillohet tubimi, ligji i klasifikon ato në tre grupe kryesore:

Tubime në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarit të policisë jo më vonë se tre ditë para datës së zhvillimit të tubimit. Për rastet urgjente³, kur tubimet janë të organizuara për shkak të rrethanave drastike, njoftimi duhet të dorëzohet 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

Tubime në vende të hapura për publikun⁴, mund të organizohen edhe pa njoftim paraprak të policisë, por organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve ku është duke u organizuar tubimi.

Tubime në zona private, ku policia nuk mund të hyjë pa lejen e drejtuesit të tubimit ose pronarit të saj, me përjashtim të rasteve flagrante për të ndaluar një rrezik të çastit për jetën dhe shëndetin e pjesëmarrësve në tubim. Ligji nuk parashikon njoftim paraprak për të tilla tubime.

Ligji për tubimet në Shqipëri nuk i njeh tubimet spontane⁵ dhe shprehet qartazi: "Kur grupe njerëzish mbledhen në mënyrë spontane dhe nuk shkelin rendin publik, aktiviteti i tyre nuk

¹ Neni 1, Ligji për Tubimet

² Udhëzuesi për Lirinë e Tubimit, botimi i dytë, OSBE / ODIHR, shënimi shpjegues 3, fq. 55

³ Neni 7, Ligji për Tubimet

⁴ Neni 12, Ligji për Tubimet

⁵ Udhëzuesi për Lirinë e Tubimit, f. 4.3, "Një tubim që zhvillohet në të njëjtën kohë dhe vend si një tjetër, por që nuk ka lidhje me ngjarjen tjetër" – përkufizimi sipas Udhëzuesit.

konsiderohet "tubim"⁶. Në këtë rast nënkuptohet se nëse një tubim i tillë do të ndodhë, Policia e Shtetit mund të mos e garantojë atë.

Sipas ligjit për tubimet, organizatori i tubimit duhet të caktojë një "lider/drejtues" dhe "personat ndihmës". Drejtuesi është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin dhe mbylljen e tubimit. Ai/ajo është përgjegjës për sjelljen e duhur gjatë tubimit dhe bashkëpunon me Policinë e Shtetit⁷. Udhëheqësi ka të drejtë të lejojë ose të ndërpresë folësit gjatë fjalimit të tyre. Ai dhe personat ndihmës kanë autoritetin të japin urdhra për pjesëmarrësit e tubimit për të ruajtur rendin publik dhe nëse nuk i përgjigjen urdhrave të tij/saj, lideri ka autoritetin të mbyllë tubimin.

Fuqia vendimmarrëse për organizimin e një tubimi në Shqipëri i takon Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit është agjencia që garanton të drejtën për të organizuar dhe marrë pjesë në tubim. Ajo ka autoritetin për të lejuar organizimin e një tubimi në sheshe dhe në vendkalimepublike, ose për ta ndaluar atë në rast se ka informacione për akte shkatërruese gjatë ngjarjes.

Sipas Nenit 5 të Ligjit për tubimet, organizata duhet të paraqesë një njoftim me shkrim tek shefi i komisarariatit të policisë, ndërsa në Nenin 6 thuhet se pas marrjes së "**kërkesës**", nëpërmjet një vendimi të argumentuar ai duhet: a) t'i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet, kufizimet e mundshme ose kushte të tjera, duke përfshirë numrin e personave ndihmës gjatë tubimit; dhe b) të japë një kopje të urdhrat zyrtar për caktimin e oficerëve përgjegjës të policisë për ndihmën dhe monitorimin e zhvillimit të tubimit. Përveç kësaj, në Kodin Penal, Neni 261 "Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme", përdoret termi "**leje**"⁸. Terminologjia e përdorur në ligj dhe kod penal është e paqartë dhe krijon konfuzion nëse është vetëm një njoftim apo një autorizim nga autoritetet për të garantuar tubimet.

Njoftimi me shkrim i Policisë së Shtetit për organizimin e një tubimi në sheshe ose vendkalime publike, duhet të përfshijë: a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe organizatorëve; b) qëllimin e tubimit; c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit si dhe itinerarin e tij d) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe e) lista e personave që do të flasin. Vendimi për mbajtjen e tubimit nga Policia e Shtetit duhet të jepet brenda 24 orëve pas pranimit të informacioneve të plota nga organizatorët. Nëse organizatorët nuk dorëzojnë të gjithë informacionin përkatës, u kërkohet nga Policia e Shtetit ta plotësojnë atë sipas parashikimeve në ligj. Rishikimet e informacionit të plotë mund të bëhen të paktën 24 orë para fillimit të tubimit⁹.

⁶ Neni 2, pika 5, Ligji për Tubimet

⁷ Neni 11, Ligji për Tubimet

⁸ "Organizimi i tubimeve dhe manifestimeve në sheshe dhe rrugë publike, pa lejen paraprake nga organi kompetent, sipas dispozitave të veçanta, ose kur organizatorët shkelin kushtet e parashtruara në kërkesën për dhënien e lejes, konsiderohet vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit".

⁹ Neni 5, pika 3 Ligji për Tubimet

Shefi i Komisarariatit të Policisë duhet t'ia komunikojë vendimin organizatorit, duke përfshirë kufizimet ose ndalimet e mundshme dhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij. Ai gjithashtu është përgjegjës për caktimin e një punonjësi policie përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar sjelljen e tubimit dhe për t'u siguruar organizatorëve një kopje të vendimit për caktimin e punonjësit të policisë. Shefi i Komisarariatit të Policisë gjithashtu njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit. Siç përmendet në Raportin e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut mbi Monitorimin e Lirisë për Tubime Paqësore në Shtetet Pjesëmarrëse të OSBE-së, nëntor 2014: "Kërkesa për një përgjigje të shpejtë nga Shefi i Komisarariatit për njoftimin e një tubimi të planifikuar është një praktikë e mirë në Shqipëri, pasi garanton që organizatorët e tubimit të mos përballen me vonesa të panevojshme për të mësuar rreth kufizimeve të zbatueshme për aktivitetet e tyre¹⁰".

Autoritetet policore kanë për detyrë ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, duke garantuar zbatimin e ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut¹¹. Oficerët përgjegjës të Policisë për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, mund të urdhërojnë organizatorët, drejtuesit, personave ndihmës dhe pjesëmarrësve të ndërpresin tubimin dhe të largohen menjëherë nga vendi i zhvillimit të tubimit. Në rast se pas tri thirrjeve të qarta nga ana e policisë për shpërndarje, pjesëmarrësit nuk largohen, oficeri i policisë urdhëron shpërndarjen e tubimit me forcë. Në çdo rast, përdorimi i forcës duhet të kufizohet përherë në minimum¹².

Bazuar në nenin 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1096, datë 28.12.2015 "Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", bashkitë mund të miratojnë rregulla shtesë për përdorimin e hapësirës publike, sipas nevojave të tyre specifike. Bazuar në këtë vendim dhe kuadrin ligjor për funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Shqipëri, disa bashki kanë përgatitur dhe publikuar rregulloret e tyre për përdorimin e hapësirave publike gjatë organizimit të aktiviteteve, të miratuara nga kryetarët e bashkive përkatëse. Në disa raste, siç është Bashkia e Tiranës, "manifestimet politike" përfshihen në llojin e aktiviteteve që duhet të pajisen me leje. Në këtë rast, kërkesa për leje për të kryer "manifestim politik" nga Bashkia e Tiranës, që në fakt aplikohet edhe në llojet e tjera të manifestimeve kërkon plotësimin e një sërë dokumentesh dhe një afat kohor prej shtatë ditësh njoftimi para tubimit, në kundërshtim me ligjin për tubimet, e cila përcakton një minimum prej tre ditësh për njoftim. Organizatat e shoqërisë civile, të intervistuar, që organizuan tubimin në dy vitet e fundit në Tiranë, thanë se nuk i dorëzuan të gjitha dokumentet e kërkuara sipas kësaj procedure. Ata zakonisht e njoftojnë Bashkinë në njoftimin e dorëzuar në Policinë e Shtetit sipas ligjit për tubimet. Megjithatë, kjo

¹⁰ <http://www.osce.org/odihr>

¹¹ Neni 2 i Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit"

¹² Neni 23, pika 2 Ligji për Tubimet

praktikë nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe udhëzuesin për lirinë e tubimeve, gjë që krijon konfuzion, procedura të rënduara për organizatorët e tubimeve si dhe hapësirë për kufizime të tubimeve.

Nga ana tjetër, mund të përmendet rasti i Bashkisë së Shkodrës e cila nuk ka përfshirë asnjë lloj tubimi (siç përcaktohet në ligjin për tubimet) në rregulloren e saj për menaxhimin e hapësirave publike. Bashkitë, si autoritete vetëqeverisëse, mund të miratojnë urdhra ose rregullore sa i përket funksionimit të tyre. Praktika tregon se jo të gjitha bashkitë kanë rregullore të posaçme për "përdorimin e hapësirës publike" ose më saktësisht për "kryerjen e manifestimeve politike" si në rastin e Tiranës, që do të thotë se tubimet e organizuara në qytete të tjera mund të bazohen vetëm në Ligjin për Tubimet.

Sa i përket kufizimeve, kuadri ligjor limiton të drejtën për të organizuar tubimet vetëm nëse rrezikohet siguria kombëtare, siguria publike, mbrojtja e rendit, parandalimi i krimit, ruajtja e shëndetit ose moralit ose mbrojtja e të drejtave dhe lirive të tjerëve¹³. Në rastet kur Policia e Shtetit, bazuar në prova, gjykon se masat më pak kufizuese nuk mund të parandalojnë një rrezik real për sigurinë kombëtare, atëherë tubimi është i ndaluar¹⁴. Kufizimet gjithashtu rregullohen në Nenet 18, 19 dhe 20 të ligjit për tubimet, sipas të cilave pjesëmarrësit janë të ndaluar të mbajnë mjete ose pajisje të cilat, gjatë përdorimit të tyre, mund të shkaktojnë dëmtime për jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Flamujt dhe parullat janë të përjashtuara nga ky detyrim. Është e ndaluar të marrësh pjesë në tubim duke përdorur sende ose veshje me qëllim fshehjen e identitetit. Në tubimet të organizuara në vende publike, organizatorët, drejtuesit, personat ndihmës dhe pjesëmarrësit nuk u lejohet të mbajnë uniforma, shenja apo simbole që u referohen grupimeve që promovojnë diskriminimin dhe dhunën me bazë racore, etnike ose fetare.

Ligji për Tubimet përcakton sanksione për katër lloje kundravajtje penale. Për pjesëmarrjen në tubimet e ndaluara dhe mosbindjen ndaj urdhrave të policisë për të shpërndarë një tubim janë sanksione me gjoba nga 1,000 në 10,000 Lekë. Sa i përket përdorimit të veshjeve dhe sendeve të tjera që kanë për qëllim fshehjen e identitetit të pjesëmarrësve në tubim dhe përdorimin e simboleve dhe shenjave diskriminuese dhe raciste, sanksionohen me gjoba (shuma është e papërcaktuar në ligj) ose burgim deri në gjashtë muaj. Në anën tjetër, Kodi Penal parashikon lloje të tjera të sanksioneve për: organizimin e tubimeve **pa leje** nga organet e autorizuara janë sanksione me gjobë (shuma e papërcaktuar) ose deri në një vit burgim; pjesëmarrja në tubimet e paligjshme sanksionohet me gjobë (shumë e papërcaktuar) ose me burgim deri në tre muaj; nëse kundërvajtja përsëritet, sanksionet variojnë nga gjobë

¹³ Neni 1, pika 2 Ligji për Tubimet

¹⁴ Neni 8, Ligji për Tubimet

deri në dy vjet burgim¹⁵. Seksionet e mësipërme të parashikuara në kuadrin ligjor nuk janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.¹⁶¹⁷

Në Raportin për Monitorimin e Lirisë për Tubime Paqësore në shtete të përzgjedhur, anëtarë të OSBE-së fq. 58, rekomandohet që të gjitha shtetet "të sigurojnë që ligjet nuk përmbajnë sanksione të paqarta apo të papërcaktuara, të cilat mund të krijojnë hapësirë të tepërt të zbatimit të ligjit nga zyrtarët apo që mundësojnë vendosjen e sanksioneve të tepërta dhe joproportionale mbi protestuesit".

Vendimet e Policisë së Shtetit mund të apelojnë nga organizatorët¹⁸. Megjithatë, ligji është shumë i përgjithshëm në lidhje me procesin e ankimit, dhe parashikon vetëm se ankimi duhet të bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Ai nuk tregon dhe nuk jep ndonjë udhëzim se si duhet të bëhet ankimi, kur, cili është autoriteti ku paraqitet ankesa dhe kur duhet të merret vendimi për të mundësuar organizimin e tubimit.

Media zakonisht i mbulon tubimet në Shqipëri. Përfaqësuesit e medias kanë të drejtë të jenë të pranishëm gjatë tubimit dhe duhet të pajisen me një kartë anëtarësie në media¹⁹. Nuk ka patur rast të mbajtjes apo ndalimit të gazetareve gjatë tubimeve të dy viteve të fundit. Institucione të tjera në Shqipëri dhe organet ndërkombëtare kanë monitoruar tubimet pa ndonjë problem të hasur gjatë tyre²⁰.

Sa i përket procesit të monitorimit të tubimeve, Avokati i Popullit në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm. Autoriteti ka të drejtë të mbikëqyrë me kujdes proceset dhe procedurat, të marrë ankesa dhe të bëjë rekomandime tek autoritetet shtetërore përgjegjëse.²¹ Të drejtat e Avokati i Popullit për të bërë rekomandime kur identifikohen rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut përcaktohen në: a) Paragrafin 3 të Neni 63 të Kushtetutës, ku citohet: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"; b) Neni 21 / c, i ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit* ", " ... Avokati i Popullit paraqet rekomandime për të vënë në vend të drejtën e shkelur për autoritetin që ka shkaktuar kundravajtje".

Për periudhën 2016-2017, Avokati i Popullit ka monitoruar dhe dorëzuar rekomandime për disa tubime:

Një protestë masive qytetare u organizua në vitin 2016 kundër ndërtimit të një sheshi lojrash brenda zonës së gjelbëruar pyjore në Parkut të Liqenit të Tiranës. Gjatë protestave, tre civilë u shoqëruan në rajonin e policisë. Për rastin në fjalë, Avokati i

¹⁵ Neni 262 i Kodit Penal

¹⁶Raporti i Raportuesit Special për të drejtat dhe lirinë e tubimit paqësor dhe të organizimit, Maina Kiai ", United Nations Human Rights Council A / HRC / 23/39, 24 prill 2013, paragrafi 51

¹⁷ The Guidelines fq. 109-112

¹⁸ Neni 25, Ligji për Tubimet

¹⁹ Neni 4, Ligji për Tubimet

²⁰ <https://www.lgbtqnation.com/2017/05/albania-pride-held-without-protests-violence>

²¹ <http://gazeta-shqip.com/lajme/2017/04/24/eksperte-te-avokatit-te-popullit-do-monitorojne-protesten-e-opozites/>

Popullit hetoi veprimet dhe mosveprimet e oficerëve të policisë. Në fund të hetimit, Avokati i Popullit arriti në përfundimin se kishte veprime të paligjshme dhe arbitrare dhe dhunë kundër pjesëmarrësve në tubim nga ana e punonjësve të policisë. Avokati i Popullit u rekomandoi autoriteteve shtetërore nevojën për të respektuar dispozitat ligjore në rastet e shoqërimit të individëve në polici. Policia e Shtetit mori masa disiplinore për dy oficerë. Gjithashtu, Avokati i Popullit i rekomandoi Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë të fillonte një hetim për veprën penale "kryerja e akteve arbitrare" ndaj policëve. Prokuroria e hodhi poshtë kërkesën e Avokatit të Popullit për të filluar një hetim për ta.

Në 2017, Avokati i Popullit vëzhgoi nga afër për disa muaj protestën e opozitës në bulevardin kryesor përpara Kryeministrit. Një rekomandim për Ministrinë e Shëndetësisë për të siguruar një shërbim adekuat shëndetësor për protestuesit, përmes një ambulance dhe personelit mjekësor, sipas nevojës, është lëshuar nga institucioni. Rekomandimet u pranuan dhe mbështetja mjekësore u sigurua deri në fund të mitingut nga autoritetet përkatëse.

Tubimet e viteve të fundit kanë qenë kryesisht të udhëhequra nga pakënaqësia ndaj qeverisë dhe performancës së institucioneve publike, duke adresuar mungesën e transparencës dhe llogaridhënies së këtyre autoriteteve publike për të kryer dhe ofruar shërbime publike, duke e parë punën e tyre të ekspozuar ndaj praktikave korruptive²². Tubimet më të shpeshta, veçanërisht ato të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile kanë qenë të lidhura me fushat e tyre të punës dhe përpjekjet e tyre të avokimit²³. Shqetësimet kryesore të ngrituranëpërmjet këtyre tubimeve janë lidhur kryesisht me mbrojtjen e mjedisit dhe zonave të gjelbra, çështjet sociale dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, duke pasur një natyrë të veçantë, në vitin 2016 - 2017, një grup joformal i quajtur Grupi i Qytetarëve Pro Reforës në Drejtësi advokoi dhe lloboi për miratimin nga Parlamenti Shqiptar të paketës ligjore për rivlerësimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe këshilltarëve ligjorë, të njohur ndryshe si procesi i "vetingut", në kuadër të reformës në drejtësi në vend. Përveç kësaj, për shkak të përkatësive politike dhe mekanizmave të ngritur për të mobilizuar mbështetësit, partitë opozitare gjatë dy viteve të fundit kanë organizuar tubim publike, ku ai më i dukshmi dhe më i gjati në kohë, ishte ai i organizuar në mars 2017, kur protestat e partive opozitare bojkotuan Parlamentin dhe ngritën një tendë në bulevardin midis Kryeministrit dhe Parlamentit.

Tubimet janë organizuar kryesisht në kryeqytet, pranë ambienteve të institucioneve publike përgjegjëse për çështjen e drejtuar nga tubimi. Duhet të theksohet fakti se tubimet e

²² D. Adonov, T. Cvjetićanin, B. Georgievski, I. Trajkoska, I. Londo, Z. TRAJKOSKA, Komunikimi i Protestave të qytetarëve, që kërkojnë përgjegjësi publike: Studime të rasteve nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, fq. 64

²³ USAID 2017, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2016 për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë, fq. 32

organizuara nga iniciativat e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile gjatë dy viteve të fundit kanë rezultuar të kenë mbështetje më të madhe për çështjet e ngritura, me shkallë të ndryshme të suksesi²⁴.

Sipas artikujve të medias, autoritetet policore në përgjithësi i kanë respektuar dhe lejuar tubimet në dy vitet e fundit, ndërkohë që kufizimet apo ndalimet kanë qenë të lidhura kryesisht me çështje të cënimit të rendit dhe sigurisë. Protesta e organizuar nga Aleanca Kundër Importit të P(AKIP) është një nga shembujt më të mirë të organizimit të tubimeve. Protesta u organizua në tetor 2016, përpara ndërtesës së Kryeministrit dhe Presidencës. Organizatorët, të cilët u bashkuan me qytetarët kërkuan shfuqizimin e ligjit për importimin e mbetjeve nga vendet e tjera. Ata gjithashtu i kërkuan Presidentit të mos e dekretonte ligjin. Protesta u organizua në mënyrë paqësore dhe u respektua nga forcat policore që ishin të larta në numër (rreth 500 policë mbikëqyrën protestën dhe rrethuan Kryeministrinë). Si rezultat, Presidenti Shqiptar refuzoi të dekretonte ligjin duke deklaruar se ligji i ri për menaxhimin e mbeturinave shkeli nenin 59 të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe direktivën e BE-së për mbetjet.

Një zhvillim tjetër pozitiv në dy vitet e fundit është se grupet e shoqërisë civile kanë qenë më të angazhuar dhe më të organizuar në shprehjen e shqetësimeve të tyre për çështje të ndryshme socio-politike. Protestat kundër hidrocentraleve në lumenjtë e Valbonës dhe Vjosës, apo kundërshtimi ndaj importeve të mbeturinave, dallojnë si shembuj të mirë. Ata ushtruan presion mbi institucionet përmes , rasteve gjyqësore dhe protestave paqësore. Megjithëse vetëm disa iniciativa prodhuan rezultate konkrete, ata treguan qeverinë se qytetarët janë të vetëdijshëm dhe u japin zë shqetësimeve të njerëzve²⁵.

²⁴ Ibid

²⁵ Raporti i Freedom House 2017



Kuadri Ligjor dhe Zbatimi

A ka pasur ndonjë ndryshim (ose propozim për ndryshim) në ligjin që lidhet me lirinë e tubimit në periudhën e mbuluar nga ky raport?

A ka pasur ndonjë zhvillim pozitiv / negativ në lidhje me mënyrën se si administrohet ligji (duke përfshirë policimin e tubimeve)?

Vlerësimet e përgjithshme të monitorimit mbi të drejtën për të organizuar lirisht dhe për të marrë pjesë në tubime gjatë dy viteve të fundit, janë përgjithësisht pozitive²⁶.

Në vitet e fundit, nuk ka patur ndryshime në ligjin që rregullon lirinë e tubimit në Shqipëri, përkatësisht Ligji nr. 8773, "Për Tubimet". Ndryshimet e fundit në ligj janë bërë në vitin 2001. Me miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave, kushteve dhe procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike", kërkesa shtesë për organizatorët e tubimeve janë paraqitur nga Bashkia e Tiranës, duke dekurajuar procesin e tubimit të lirë dhe paqësor.

Përsa i përket administrimit dhe zbatimit pozitiv në praktikë, janë përmirësuar ndjeshëm tubimet (kryesisht protesta politike anti-qeveritare) krahasuar me disa vite më parë. Një shembull pozitiv i tubimit të lirë është manifestimi i partive opozitare të organizuara në shkurt-mars të vitit 2017. Anëtarët e partive opozitare shqiptare ngritën një tendë në Bulevardin "Dëshmorët e Kombit" për të kërkuar një qeveri teknike dhe zgjedhje të lira. Shumë shtetas shqiptarë demonstuan në mënyrë paqësore dhe policia nuk ndërhyri për të shpërndarë protestuesit apo për të hequr tendën, e cila bllokoi trafikun në një rrugë kryesore²⁷ (Reuters, 2017). Krahasuar me tubimin e vitit 2011 të organizuar në atë kohë nga Partitë Opozitare (partia në pushtet në vitin 2017), gjatë së cilës katër persona u qëlluan për vdekje, shumë të tjerë u plagosën dhe më shumë se 113 u arrestuan, ky shihet si një përmirësim domethënës në administrimin e tubimeve nga autoritetet shtetërore.

²⁶ Liria e Tubimit Paqësor dhe Shoqata ALBANIA 13 Raportet e Vendeve mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për 2016 Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punë <https://www.state.gov/documents/organization/265600.pdf>. "Kushtetuta dhe ligji parashikojnë liritë e tubimit dhe shoqërimin dhe qeveria në përgjithësi i ka respektuar këto të drejta".

²⁷ <https://www.reuters.com/article/us-albania-opposition-protests/albanian-protesters-rally-pitch-tent-to-demand-free-elections-idUSKBN15X0OI>

Dy oficerë të Gardës Shqiptare u ndoqën penalisht dhe u shpallën fajtorë pasi qëlluan mbi protestuesit në 21 janar 2011 në protestat e opozitës në Tiranë²⁸. Vendimi i gjykatës u lëshua pas 3 vitesh gjykim. Prokuroria kërkoi dënimin e tyre me 23 dhe 25 vjet burg, ndërsa Gjykata e Apelit në Tiranë i dënoi ata me 1 dhe 3 vjet burg. Gjykata e Lartë refuzoi apelimin e çështjes nga Prokuroria dhe rasti është mbyllur.

Një përmirësim tjetër gjatë dy viteve të fundit në organizimin e protestave në Shqipëri është që këto organizime janë udhëhequr nga grupe të ndryshme interesi (siç janë ambientalistët dhe profesionistët e tjerë) të cilët ishin të vendosur të mos lidheshin me ndonjë parti politike. Numri i protestave që nuk kanë lidhje me politikën është rritur në Shqipëri, kryesisht në qytetin e Tiranës. Kjo është në kontrast me disa vite më parë, kur shumica e tubimeve organizohej dhe udhëhiqej nga partitë politike. Shembuj të mirë janë tubimet e organizuara për çështjet mjedisore dhe protestat e studentëve kundër ligjit të ri për arsimin e lartë²⁹.

Në dy vitet e fundit ka patur raste soporadike të shembujve negativë të administrimit të protestave, ndaj është e nevojshme të bëhen përmirësime të mëtejshme në rritjen e llogaridhënies së autoriteteve përgjegjëse për administrimin e tubimeve në vend. Në shkurt të vitit 2016, aktivistë qytetarë në Shqipëri protestuan kundër planit të Bashkisë së Tiranës për të ndërtuar një park lojrash për fëmijë pranë parkut të liqenit artificial të qytetit. Protesta e drejtuar nga qytetarët kundër projektit të ndërtimit të këtij parku, u përball me ashpërsinë e zyrtarëve të qeverisë vendore, të cilët i quajtën protestuesit si instrumente të Partisë Demokratike të opozitës dhe "vandalë". Çështja mori mbulim të paktë të mediave, pavarësisht faktit se policia përdori forcën për shpërndarjen e protestave ku dhe arrestoi 12 pjesëmarrës më 21 shkurt 2016³⁰.

²⁸ Raport Special ECHR shkurt 2011 CommDH (2011)9

²⁹ <http://www.balkaninsight.com/en/article/protests-thrive-in-albania-02-23-2016>

³⁰ <https://globalvoices.org/2016/03/24/albanian-activists-rally-against-a-concrete-end-for-tiranas-last-public-park/>



Policimi i Tubimeve

A angazhohet përgjithësisht policia në format e dialogut / komunikimit me organizatorët para ose gjatë një tubimi?

A lehtëson dhe mundëson përgjithësisht policia tubime spontane / jo të njoftuara; tubime që ndodhin në të njëjtën kohë; kundërprotesta; tubime paqësore që bllokojnë rrugët / trafikun; bllokimin e ndërtesave?

A përdor policia ndonjëherë forcë gjatë tubimeve? Cilat janë llojet e armëve dhe pajisjeve të tjera të përdorura? A ofrohet përgjithësisht ndihmë mjekësore për njerëzit që mund të kenë nevojë?

A angazhohen ndonjëherë policë të infiltruar në tubime?

Çfarë mjetesh vëzhgimi dhe mbledhjesh të të dhënave pamore përdor policia gjatë tubimeve? A i lejon policia pjesëmarrësit në tubime të filmojnë apo fotoqafajnë pamje të veprimeve të policisë?

Liria e tubimit, siç thuhet në Kushtetutë dhe në dokumentet ndërkombëtare, është një e drejtë dhe jo një privilegj. Kështu, policimi i çdo lloji tubimi duke mbrojtur pjesëmarrësit, duke i lejuar ata të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre është sfida kryesore për qeverinë. Policia demonstroi angazhimin e një shteti për të respektuar sundimin e ligjit dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të njeriut³¹.

Bazuar në informacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, gjatë dy viteve të fundit, janë paraqitur në strukturat e policisë në Shqipëri 1,369 kërkesa për organizimin e tubimeve, prej të cilave vetëm 5 janë ndaluar. Arsyet kryesore të refuzimit u janë referuar Neneve 8 dhe 9 të Ligjit nr. 8773, "... kur siguria kombëtare dhe publike janë vënë në rrezik ...". Megjithatë, edhe pse nuk kanë marrë miratimin e autoriteteve, tubimet gjithsesi janë organizuar.

Kuadri ligjor shqiptar nuk parashikon asnjë angazhim nga ana e policisë për takime, negociata apo komunikime me organizatorët përpara apo gjatë procesit të organizimit të një tubimi. Kjo reflektohet në praktikë, pasi komunikimi konsiderohet shumë burokratik dhe përgjithësisht nuk zhvillohen takime midis organizatorëve dhe policisë. Lidhur me komunikimin me policinë gjatë tubimeve, organizatorët janë shprehur pozitivisht. Sipas tyre,

³¹Udhëzuesi i të Drejtave të Njeriut mbi Policimin e Tubimeve

oficerët përgjegjës të policisë kanë qenë bashkëpunues dhe pjesëmarrësit janë ndjerë të mbrojtur.

Një shembull i administrimit të mirë të dy tubimeve të organizuara në të njëjtën kohë në të njëjtin vend, është parada kombëtare vjetore e LGBTQI organizuar në mars të vitit 2017, që përkoi të ndodhte në të njëjtën ditë dhe vend me protestën e opozitës në bulevardin kryesor të kryeqytetit. Sipas informacioneve të mbledhura në këtë rast, organizatorët e paradës LGBTQ u takuan me përfaqesues të Partisë Demokratike për t'u siguruar që të dy tubimet të zhvillohen paqësisht, pa incidente dhe vendosën bashkarisht për kohën dhe itinerarin më të përshtatshëm, duke patur parasysh numrin e madh të pjesëmarrësve në të dy tubimet. Avokati i Popullit, institucionet dhe Trupi Diplomatik në Shqipëri monitoruan paradën. Policia e Shtetit demonstroi kapacitet të plotë për të mundur që të dy tubimet të zhvillohen paqësisht pa asnjë incident.

Në Shqipëri, gjatë vitit të kaluar ka patur disa protesta të rëndësishme që zgjatën më shumë se një ditë. Partia Demokratike dhe parti të tjera opozitare protestuan nga mesi i shkurtit deri në qershor, kur mijëra njerëz u mbledhën për të protestuar në një tendë para zyrës së Kryeministrit³².

Në shkurt 2017, banorë nga fshati Zharrëz i qytetit të Fierit marshuan rreth 100 kilometra drejt Tiranës në një protestë të heshtur për refuzimin nga ana e qeverisë për gjetjen e një zgjidhjeje për pasojat negative shkaktuar nga nxjerrja e naftës nga kompani private pranë zonave ku ndodhen shtëpitë të tyre³³. Banorët e fshatit Zharrëz qëndruan para Ministrisë së Energjisë me kërkesat e tyre dhe më në fund, më 1 mars 2017, qeveria premtoi të kompensojë fshatarët për dëmtimin e shtëpive të tyre nga shpimet e naftës aty pranë.

Në situatat e lartpërmendura, raportet tregojnë se nuk ka patur raste të ndalimit të tubimeve apo kufizim të kohës apo vendit të kryerjes së protestave. Partia Demokratike e opozitës kishte leje për të protestuar vetëm për katër orë, e megjithatë ata vazhduan të protestonin për muaj me radhë pa asnjë ndërhyrje nga autoritetet. Edhe pse nuk u regjistruan arrestime arbitrare, policia nisi procedim penal ndaj kreut të Partisë Demokratike (PD), Lulzim Basha, për nxitje të dhunës³⁴. Gjithashtu, Bashkia e Tiranës gjobiti PD-në për dëmet e shkaktuara gjatë protestës.³⁵ Bashkia e Tiranës dokumentoi me video dhe foto të gjitha dëmet materiale të shkaktuara ndaj publikut dhe llogariti dëmin e pronës publike prej 163,729,000 Lekë. Duke shprehur respektin e saj për protesta demokratike dhe qytetare, por në të njëjtën kohë duke dënuar vandalizmin, Bashkia e Tiranës ia ngarkoi shumën e lartpërmendur si gjobë Partisë Demokratike (PD), si përgjegjës kryesor për organizimin e protestës. PD-ja ngriti një padi kundër Bashkisë, duke kërkuar pavlefshmërinë dhe shfuqizimin e akteve administrative të

³² 2017_Protesta e opozitës

³³ <http://www.tiranatimes.com/?p=131318> "Zharrez hunger strikers start 100 km protest march to Tirana"

³⁴ <http://www.dw.com/en/albania-police-charge-democrat-boss-after-rama-protests/a-37719790>

³⁵ <http://infoalbania.al/bashkia-e-tiranes-gjobit-partine-demokratike-per-demet-e-shkaktuara/>

nxjerra nga kjo e fundit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në Tiranë vendosi pranimin e pjesëshëm të padisë nga Partia Demokratike.

Gjatë vitit 2016-2017 ka patur të dhëna për "përdorim të forcës" nga policia në gjashtë³⁶ tubime. Policia i arsyetoi këto veprime si përgjigje ndaj dhunës³⁷ të iniciuar nga protestuesit, ose për shkak se pjesëmarrësit nuk iu përgjigjën urdhrat të policisë për t'u shpërndarë³⁸. Sipas ligjit për tubimet, oficeri përgjegjës i policisë dhe kujdestarët e tij duhet t'u bëjnë të paktën tri thirrje verbale organizatorëve dhe pjesëmarrësve para fillimit të shpërndarjes dhe forca duhet të jetë minimale. Në çdo rast, dëshmitë e ngjarjeve të tubimit duhet të jenë të disponueshme dhe të siguruar nga policia. Mbledhja e provave gjatë një tubimi është me rëndësi të madhe për të pasur dëshmi se çfarë ka ndodhur gjatë tij. Faktet duhet të ndihmojnë autoritetet dhe gjithashtu të ofrojnë një frenim psikologjik që mund të dekurajojë kriminelët e mundshëm nga shkelja e ligjit³⁹.

Lidhur me përdorimin e armëve, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 14.10.2015 "Për përdorimin e armëve të zjarrit", forcat policore **nuk mund** të përdorin armë zjarri në asnjë rrethanë në rastin e tubimeve paqësore, qofshin ato të ligjshme apo të paligjshme. Përdorimi i armëve të zjarrit për të shmangur rrezikun publik lejohet vetëm kundër personave të armatosur që kryejnë veprime të dukshme të dhunës, kur përdorimi i mjeteve të tjera kufizuese ka dështuar. Shkopinjë e gomës, prangat, kamerat dhe telekamerat janë pajisjet tipike të punonjësve të policisë në tubimet paqësore. Gama e pajisjeve të tjera si pompa uji me presion, megafonë, skela, mburoja plastike, skafandra, gaz lotsjellës e të tjera mund të përdoren vetëm në rastet kur protestuesit zhvillojnë akte të dhunshme.

Gjatë tubimeve në sheshe dhe vende publike ose tubimeve të hapura për publikun, policia mund të regjistrojë zëra, filma ose të fotografojë vetëm nëse ka arsye për të besuar se ekziston një rrezik imediat i rendit dhe sigurisë publike⁴⁰. Regjistrimet, pamjet dhe fotografitë duhet të shkatërrohen menjëherë pas tubimit, në rast se nuk nevojiten:

- a. për të filluar procedime penale të pjesëmarrësve;
- b. për parandalimin e rrezikut, kur besohet se personi i filmuar mund të kryejë vepra penale në tubime të ardhshme.

Policia i lejon pjesëmarrësit të regjistrojnë veprimet e policisë në përgjithësi pa asnjë kufizim.

³⁶ <https://rm.coe.int/16806db80b>

³⁷ <https://www.reuters.com/article/us-albania-opposition-protests/albanian-protesters-vent-anger-at-pms-office-torch-bunker-idUSKBN0TR20D20151208>

³⁸ <https://www.asp.gov.al/index.php/component/content/article/17-shqip/lajmet-e-fundit/11597-informacion-mbi-ngjarjet-arrestimet-ndalimet-dhe-procedimet-ne-24-oret-e-fundit-25-04-2017>

³⁹ Udhëzuesi i të Drejtave të Njeriut mbi Policimin e Tubimeve, fq 70

⁴⁰ Neni 21 Ligji për Tubimet



Media dhe Tubimet

A janë masmediat në gjendje të raportojnë lirisht në tubime?

A mund të raportojnë lirisht gjatë tubimeve gazetarët e akredituar ose jo të akredituar?

A mund të vëzhgojnë lirisht tubimet mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe monitoruesit e tjerë?

Roli i medias është shumë i rëndësishëm në dhënien e informacionit gjatë tubimeve. Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e fjalës dhe kuadri ligjor nuk kufizon përdorimin e informacionit apo të lajmeve brenda ose jashtë vendit. Por, ndërsa kuadri ligjor mundëson ushtrimin e kësaj të drejte, ka nevojë për përmirësime në zbatimin e tij në praktikë.⁴¹ Për më tepër, mediat që janë kritikuese ndaj punës së autoriteteve publike shpesh janë subjekt i presioneve, padive apo kërcënimeve për sigurinë e vendeve të punës për gazetarët⁴².

Mbulimi mediatik i protestave në përgjithësi është konsideruar neutral, por sipërfaqësor. Raportimet e medias rrallë thellohen në trajtimin e çështjeve për të cilat organizohen protestat, duke u kujdesur më shumë për të qenë "politikisht korrekt", në vend të raportimeve që do të jepnin një pamje të plotë të dinamikave dhe arsyeve të protestave si dhe adresimin e problemeve themelore të protestave.⁴³

Gjatë dy viteve të fundit, shumë nga tubimet organizuar nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) janë mbuluar disi mediatikisht, kryesisht ato të organizuara për të drejtat e grave dhe fëmijëve si dhe mbrojtjen e mjedisit⁴⁴. Në një sondazh të kryer me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC)⁴⁵, 90% e OSHC-ve (nga 96%) deklaruan se media ka marrë pjesë lirisht në tubimet e organizuara prej tyre. Gjatë tubimit të organizuar nga banorët e Shkozës, në Tiranë kundër qeverisë dhe Bashkisë së Tiranës për të prishur 153 shtëpi për rindërtimin e Unazës së Madhe të Tiranës, gazetarët nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese⁴⁶ nuk u lejuan nga forcat e policisë të ndjekin nga afër tubimin⁴⁷.

⁴¹ Raporti i Progresit për Shqipërinë 2016

⁴² Freedom House 2017

⁴³ http://www.media.ba/sites/default/files/policy_brief_albania.pdf

⁴⁴ USAID 2017, Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë, fq. 30

⁴⁵ Sondazhi është kryer nga Partnerët Shqipëri në kuadër të përgatitjes së Matricës së Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë 2016.

⁴⁶ BIRN Shqipëri është një organizatë jofitimprëse, që ka si objekt promovimin e mediave të lira dhe të pavarura me qëllim informimin e publikut për çështjet që kanë të bëjnë me korrupsionin, mosndëshkimin, situatën e të drejtave të njeriut etj në Shqipëri dhe rajon.

⁴⁷ Informacioni i mbledhur nga intervista me përfaqësues të organizatës Birn Shqipëri

Në një raport me raste studimore nga vendet e rajonit në lidhje me organizimin e protestave, një nga problemet e hasura gjatë protestave është se jo gjithmonë mesazhi i dhënë nga protestuesit për gazetarët, merr mbulim përmes mediave, jo vetëm për shkak të mungesës së kapaciteteve të organizatorëve, por edhe për shkak të mungesës së interesit të mediave në çështjen për të cilën protestohet⁴⁸.

Në përgjithësi nuk ka kufizime për mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe institucione të tjera monitoruese për të marrë pjesë dhe për të vëzhguar lirinë e tubimeve në Shqipëri.



Media Sociale dhe Tubimet

A e përdorin organizatorët dhe pjesëmarrësit në tubime median sociale përpara, gjatë ose pas tubimeve?

A ka vendosur qeveria apo autoritete të tjera ndonjë kufizim në përdorimin e medias sociale lidhur me tubimet?

66.4% e popullsisë në Shqipëri janë përdorues të internetit⁴⁹ dhe sipas Statistikave Evropiane të Internetit⁵⁰, mbi 1.4 milionë shqiptarë janë përdorues të Facebook-ut. Nga hulumtimet dhe vëzhgimet e tubimeve organizuar në dy vitet e fundit, media sociale, e në veçanti Facebook-u, ka qenë një nga mjetet e komunikimit që është përdorur më së shumti nga organizatorët dhe pjesëmarrësit në tubimeve për të shpërndarë informacion dhe për të rritur numrin e mbështetësve. Platforma më e përdorur e medias sociale nga organizatorët e tubimeve është Facebook-u. Në përgjithësi, organizatorët e tubimeve krijojnë një faqe në Facebook, duke identifikuar emrin dhe çështjen për të cilën protestohet dhe e ushqejnë përmbajtjen e faqes me informacion, fotografi, diskutime me ndjekësit, postime të ndryshme me artikuj, video dhe deklarata për tubimin. Sidoqoftë, edhe pse rrjetet sociale përdoren gjerësisht dhe preferohen në organizimin e protestave dhe mobilizimin e protestuesve, kur bëhet fjalë për

⁴⁸ D. Adonov, T. Cvjetičanin, B. Georgievski, I. Trajkoska, I. Londo, Z. Trajkoska, Komunikimi i Protestave të qytetarëve, që kërkojnë përgjegjësi publike: Raste studimore nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, fq.122

⁴⁹ CIA World Factbook (est. korrik 2016)

⁵⁰ <http://www.internetworldstats.com/europa2.htm> (est. qershor 2016)

ndjeshmërinë e publikut, masmedia konsiderohet forma më efektive për përhapjen e informacionit⁵¹.

Qeveria nuk vendos asnjë kufizim për përdorimin e medias sociale dhe organizatorët/pjesëmarrësit mund t'a përdorin atë para, gjatë dhe pas organizimit të tubimit. Shpesh, përdorimi i medias sociale ka ushqyer me informacione edhe masmedia, duke ofruar informacion për gazetarët⁵². Sipas të dhënave të një sondazhi zhvilluar me pjesëmarrjen e 96 OSHC-ve, asnjë prej tyre nuk ka raportuar të ketë patur ndalim apo kufizim të komunikimit online⁵³.



Përgjegjësia e Organizatorëve

A mbajnë përgjegjësi organizatorët e tubimit për sjelljen e të tjerëve?

Nëse organizatorët nuk janë të identifikueshëm, si reagon policia?

Organizatorët duhet normalisht të njoftojnë policinë paraprakisht, edhe pse në rrethana të caktuara grupet mund të mbledhen në hapësirat publike pa njoftim paraprak. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: *"Kufizime të të drejtave dhe lirive mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut"*.⁵⁴

Në Matricën e fundit të Monitorimit për Mjedisin Mundësues për Organizatat e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë, 2016, 52% e OSHC-ve të anketuara kanë marrë pjesë të paktën në një tubim të organizuar në vitin 2016 dhe 18% e tyre kanë qenë edhe organizatorë të një tubimi. Shumica e OSHC-ve që kanë organizuar ose kanë marrë pjesë në një tubim (86%) kanë vlerësuar se nuk ka patur sfida gjatë organizimit apo pjesëmarrjes në një tubim paqësor.

⁵¹ http://www.media.ba/sites/default/files/policy_brief_albania.pdf

⁵² D. Adonov, T. Cvjetićanin, B. Georgievski, I. Trajkoska, I. Londo, Z. Trajkoska, Komunikimi i Protestave të qytetarëve, që kërkojnë përgjegjësi publike: Raste studimore nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia, fq.125

⁵³ Partnerët Shqipëri, Matrica e Monitorimit mbi Mjedisin Mundësues për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Raporti për Shqipërinë, 2016, Tiranë, fq. 28

⁵⁴ Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 17

Në bazë të legjislacionit në fuqi, organizatorët e tubimeve në Shqipëri mbajnë përgjegjësinë kryesore për zhvillimin dhe vazhdimin e tubimit, duke mbështetur policinë në ruajtjen e rendit dhe duke vendosur për fillimin, ndërprejen dhe përfundimin/shpërndarjen e tij.

Bazuar në ligj ata janë gjithashtu përgjegjës për ruajtjen e rendit publik. Në rastet kur rrezikohet mbarëvajtja e tubimit, drejtuesi duhet të mbyllë tubimin⁵⁵. Në rastet kur organizatorët nuk iu përmbahen kërkesave ligjore, ata mbajnë tërësisht përgjegjësi administrative deri në ndjekje penale.

Policia e Shtetit raporton rreth 83 raste në total ku organizatorët e tubimit nuk kanë bashkëpunuar me policët përgjegjës duke mos respektuar orarin e shpallur për mbajtjen e tubimit ose duke mos marrë masa për shpërndarjen e pjesëmarrësve dhe përfundimin e tubimit pas disa kërkesave nga ana e policisë.

Bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare, organizatorët e tubimeve nuk duhet të mbahen përgjegjës për moskryerjen e detyrave të tyre, nëse kanë bërë përpjekjet e mundshme për të realizuar këto detyra. Ata nuk duhet të jenë përgjegjës për veprimet individuale të pjesëmarrësve, të individëve që nuk kanë lidhje me tubimin apo agjentëve provokatorë. Neni 262 i Kodit Penal në Shqipëri⁵⁶ përcakton se organizimi i tubimit në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa leje paraprake nga autoriteti kompetent sipas dispozitave të veçanta ose kur organizatorët shkelin kushtet e parashikuara në kërkesën për leje, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Pjesëmarrja në këto tubime, madje edhe pas paralajmërimeve për shpërndarje, është një kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj. Kjo praktikisht krijon pengesë për organizimin e tubimeve nga individë që mund të ndëshkohen edhe në rastet kur veprimet e pjesëmarrësve mund të jenë jashtë kontrollit të tyre⁵⁷.

Në 24 prill 2017, në qytetin e Lushnjës, Partia Demokratike organizoi një protestë që u shoqërua me bllokimin e një aksi rrugor kombëtar në jug të Shqipërisë. Policia e Shtetit e shpalli tubimin të paligjshëm sepse nuk i kishte dhënë leje Partisë Demokratike për organizimin e tij. Protesta u zhvillua gjithsesi dhe Policia procedoi penalisht 7 individë, kryesisht organizatorë të ngjarjes, për veprën penale "Organizim dhe pjesëmarrje në tubime dhe manifestime të paligjshme", "Bllokim i trafikut rrugor" të parashikuara në nenet 262 dhe 293 të Kodit Penal⁵⁸. Sipas informacioneve të publikuara në faqen e internetit të Gjykatës së

⁵⁵ Neni 11, Ligji për Tubimet

⁵⁶ <http://www.qbz.gov.al/botime/Kodi%20Penal-2017.pdf>

⁵⁷ Raport Monitorimi i Lirisë për Tubime Paqësore në Shtetet Pjesëmarrëse të OSBE-së / OSBE dhjetor 2014: "Është e rëndësishme që shumica e gjobave të vendosura ndaj organizatorëve të tubimeve duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Dënimi i mundshëm që përfshin burgim dhe gjobë për organizatorët që nuk japin njoftim të mjaftueshëm për një tubim në Shqipëri, nuk i përmbushin këto standarde"

⁵⁸ <https://www.asp.gov.al/index.php/component/content/article/17-shqip/lajmet-e-fundit/11597-informacion-mbi-ngjarjet-arrestimet-ndalimet-dhe-procedimet-ne-24-oret-e-fundit-25-04-2017>

Rrethit Gjyqësor Lushnje, vetëm një individ u shpall fajtor dhe u dënua me një gjobë prej 75,000 Lekë.



Ndalimet dhe Ndjekjet penale

A janë arrestuar apo ndaluar ndonjëherë njerëz përpara një tubimi? Nëse po, a u është dhënë mundësia për këshillim ligjor apo ndihmë mjekësore?

A ka patur rritje të numrit të ndëshkimeve të vendosura ndaj njerëzve të arrestuar në tubimet e viteve të fundit?

A konsiderohen gjykatat si neutrale dhe të paanshme?

Përsa i përket arrestimeve dhe ndjekjeve penale, Policia e Shtetit, Zyra e Avokatit të Popullit, Prokuroria dhe Gjykatat e Rretheve janë autoritetet kryesore publike përgjegjëse për çështjet përkatëse në nivele të ndryshme të tubimit. Lidhur me organizimin dhe zhvillimin e tubimit, autoriteti i parë publik që merret me sigurinë e tubimeve është Policia e Shtetit. Ligji⁵⁹ u jep atyre të drejtën për të ruajtur rendin dhe sigurinë, duke respektuar të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Në përgjithësi kjo është respektuar edhe në praktikë.

Një shembull i identifikuar gjatë kësaj periudhe është ndalimi i një shtetasi të huaj përpara organizimit të tubimit të Partive opozitare në maj 2017. Media raportoi se në 13 maj 2017⁶⁰, ditën që Partia Demokratike organizoi tubimin kombëtar në Tiranë kundër qeverisë, një qytetar Amerikan u arrestua dhe u mbajt në komisariatit e policisë për disa orë nga Task Forca Anti-Terror në Policinë e Shtetit. Policia deklaroi se kishte informacione që ky individ hyri në Shqipëri disa ditë përpara tubimit dhe kishte bashkëpunuar me protestuesit e opozitës Shqiptare. Ai u arrestua për disa orë dhe pas verifikimeve nga ana e policisë u la në gjendje të lirë.

Ka edhe shembuj kur pjesëmarrës në tubime janë arrestuar nga policët për shkak të përplasjeve me ta. Një rast për të ilustruar këtë është protesta e organizuar nga shoqëria civile kundër ndërtimit të parkut të lojërave për fëmijë nga Bashkia e Tiranës. Pasi protestuesit hoqën gardhin në zonën ku planifikohej të ndërtohej parku i lojërave, oficerët e policisë përdorën dhunën fizike gjatë përplasjeve me qytetarët. Si rezultat, disa nga protestuesit u shoqëruan në komisariat, edhe pse më vonë veprimet e kryera nga punonjësit

⁵⁹ Neni 2. Ligji "Për Policinë e Shtetit"

⁶⁰ <http://gazeta-shqip.com/lajme/2017/05/13/ndalohet-marinsi-amerikan-thirrur-nga-pd-per-organizimin-e-protestes/>

e policisë, Avokati i Popullit i vlerësoi arbitrare dhe në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore mbi Policinë e Shtetit⁶¹.

Avokati i Popullit është autoriteti kryesor publik që ofron mbështetje për personat e ndaluar ose të arrestuar. Ai ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë veprime kur vërehet shkelje e të drejtave të njeriut nga ana e administratës publike. Për më tepër, Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit ka të drejtë t'i rekomandojë Prokurorisë që të fillojë hetime nëse konstaton se është kryer një vepër penale, ose të rihapë hetime që mund të jenë mbyllur apo pezulluar. Në ilustrim të rastit të cituar më lart, Avokati i Popullit rekomandoi fillimin e hetimeve për veprën penale të veprimeve të policëve të Komisarariatit të Policisë së Tiranës nr. 1 për dhunën fizike të ushtruar ndaj qytetarëve që protestuan në kodrat e liqenit artificial të Tiranës. Në përfundim të procesit, Policia e Shtetit mori masa disiplinore për dy oficerë policie, ndërsa Prokuroria e hodhi poshtë kërkesën e Avokatit të Popullit për të filluar një hetim për ta. Prokuroria e Tiranës nisi procedim penal ku kërkoi ndëshkimin e protestuesve për veprime të dhunshme ndaj forcave të policisë me dy muaj burg të konvertuar në 60 orë shërbimi me punë komunitare. Një vit e gjysëm pas organizimit të protestës, më 19 tetor 2017, Gjykata e Apelit të Shkallës së Parë në Tiranë, dha dënimin kundër protestuesve me një muaj shërbim prove me punë komunitare⁶².

Nuk ka informacion të publikuar në lidhje me të dhënat e dënimeve ndaj njerëzve të arrestuar gjatë tubimeve (numri, kohëzgjatja, lloji i veprës penale etj). Bazuar në hulumtimin e artikujve të medias, njoftimeve të Policisë së Shtetit dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, përgjithësisht njerëzit e arrestuar në tubime, lihen të lirë menjëherë pas përfundimit të tubimit.

Sistemi gjyqësor shihet dhe perceptohet si i njëanshëm në gjykimin e rasteve. Sipas një sondazhi ku janë pyetur 1,670 shtetas, sistemi gjyqësor rezulton të jetë institucioni më pak i besuar në Shqipëri, e konfirmuar nga 79% e të intervistuarve⁶³. Gjatë vitit 2016-2017 raportohet vetëm një rast i depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nga Partia Demokratike kundër Bashkisë së Tiranës (rasti i përmendur më lart).

⁶¹

<http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/REKOMANDIME/VITI2016/16.04.2016%20REKOMANDIM.pdf>

⁶² Informacioni është nxjerrë nga Gazeta Panorama, një gazetë e njohur në Shqipëri. Data e artikullit është 19 tetor 2017.

⁶³ IDM 2016, Sondazhi i Opinionit, Besimi në Qeverisje 2016 ", Tiranë, 2016, fq. 4



Llogaridhënia

A mbajnë përgjegjësi për sjelljen dhe veprimet e tyre gjatë organizimit të tubimeve autoritetet shtetërore (ministritë, bashkitë) apo policia e shtetit?

Gjetjet tregojnë se protestat në Shqipëri në përgjithësi nuk arrijnë të marrin një përgjigje të kënaqshme nga zyrtarët shtetërorë në aspektin e llogaridhënies. Megjithatë, në vend që t'i atribuohet natyrës specifike të procesit të komunikimit gjatë një proteste të veçantë, mungesa e llogaridhënies mund të shpjegohet si nga natyra e reagimit të zyrtarëve ndaj protestuesve, ashtu edhe nga mënyra se si media i transmeton protestat. Mënyra se si mbulohen gjithashtu perceptimin dhe rezultatin e protestave.⁶⁴

Bazuar në rregulloren e Policisë së Shtetit, kjo e fundit është përgjegjëse për të vepruar me standardet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dhe në respekt me dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.⁶⁵ Për më tepër, punonjësi i policisë është përgjegjës për veprime të paligjshme dhe forcë të pajustificuar, nëse kjo e fundit është joproportionale me masën që është e nevojshme për të arritur një objektiv legjitim⁶⁶. Punonjësit e policisë kanë shënjat në uniformën e tyre, që përmbajnë emër, mbiemër, numrin e identifikimit, pozicionin e tyre dhe strukturën (lokale ose qendrore) ku punonjësi i policisë ushtron detyrën e tij⁶⁷.

Në rastet kur forcat e policisë shkelin dispozitat ligjore, organizatorët mund të regjistrojnë ankimmim në gjykatë. Praktika tregon, se kur kanë ndodhur shkelje të tilla, organizatorët janë ankuar për rastet pranë Avokatit të Popullit, i cili pas vlerësimit të gjendjes ka rekomanduar fillimin e hetimeve nga Prokuroria. Një rast për të ilustruar këtë është shembulli i protestave për parkun e lojrave për fëmijë në Liqenin e Tiranës. Pas vlerësimit nga Zyra e Avokatit të Popullit u vërejt se oficerët e policisë kanë kryer "akte arbitrare", duke përdorur dhunën fizike kundër qytetarëve që protestonin përtej fuqive të dhëna nga ligji, duke ndikuar kështu negativisht ndaj lirisë së qytetarëve⁶⁸.

Nuk ka information të disponueshëm për publikun sa i përket llogaridhënies së agjencive apo institucioneve të tjera që luajnë rol në organizimin e tubimeve, por në përgjithësi,

⁶⁴ http://www.media.ba/sites/default/files/policy_brief_albania.pdf

⁶⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16/09/2015 "Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit", Neni 105

⁶⁶ Ibid, neni 211

⁶⁷ Ibid, neni 11, point c.

⁶⁸ https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/compliance/S2016-03_Albania/frParty_22.09.2016/3.Ombudsman_3.pdf

autoritetet publike kanë një tendencë për ta shmangur komunikimin me organizatorët e protestuesve ose i marrin në konsideratë kërkesat e tyre në rastet kur protestuesit janë këmbëngulës⁶⁹.



Vlerësim i Përgjithshëm

A respektohet, lehtësohet dhe mbrohet e drejta për tubime paqësore nga shteti?

Në përgjithësi, e drejta për tubim të lirë garantohet nga kushtetuta dhe kuadri ligjor Shqiptar dhe ushtrohet në praktikë nga të gjithë. Kuadri ligjor i ndryshuar në vitin 2001, përcakton formën dhe informacionin që organizatorët duhet t'i paraqesin Policisë së Shtetit. Përmirësimet janë të nevojshme në nivel legjislativ sa i përket njohjes së tubimeve spontane dhe kundërdemonstrave, komunikimit me autoritetet përgjegjëse që janë të përfshira në faza të ndryshme të procesit të mundësimit të tubimit dhe qartësimin të procedurave të ankimimit që duhet të ndiqen në rastet kur organizatorët ndjehen të dhunuar për të ushtruar të drejtat e tyre.

Policia e Shtetit në përgjithësi i respekton të drejtat e njeriut dhe të drejtën për tubim të lirë, përveç disa rasteve ku janë shkelur këto të drejta. Në përgjithësi policët janë shihen si profesionalë sa i përket komunikimit gjatë tubimeve, dhe pjesëmarrësit ndjehen të mbrojtur dhe të siguar në praninë e tyre.

Masmedia dhe mediat sociale janë të rëndësishme në sigurimin e informacioneve mbi tubimet dhe rritjen e nivelit të mbështetësve, prandaj në vitet e fundit shumë tubime të organizuara në Shqipëri janë mbuluar mediatikisht. Mediat që janë kritike të punës së autoriteteve publike shpesh bëhen subjekt i kërcënimeve, padive apo presioneve të ndryshme ndaj gazetarëve.

Qeveria nuk e kufizon përdorimin e mediave sociale dhe organizatorët/pjesëmarrjet mund ta përdorin atë para, gjatë dhe pas organizimit të tubimit.

Sa i përket shoqërimit, ndjekjes penale dhe llogaridhënies së agjencive/institucioneve që janë të përfshira në tubime, nevojitet më shumë informacion publik në dispozicion për të patur një pasqyrë më të qartë të rolit të tyre.

⁶⁹ Instituti Shqiptar i Medias 2015, Praktikat e komunikimit dhe llogaridhënies, fq. 7
http://www.media.ba/sites/default/files/policy_brief_albania.pdf

REKOMANDIME

Për të përmirësuar më tej lirinë e tubimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare, propozohen rekomandimet si më poshtë:

1. Të përmirësohet kuadri ligjor (Ligji për Tubimet dhe Kodi Penal) mbi rolin dhe autoritetin e Policisë së Shtetit në lidhje me njoftimin për organizimin e një tubimi në sheshe dhe në vendkalime publike.
2. Kuadri ligjor të sigurojë mbrojtje për të gjithë qytetarët që organizojnë ose marrin pjesë në tubime paqësore, duke përfshirë ato spontane, kundërprotestat dhe tubimet që nuk kanë një organizator të identifikuar, në përputhje me udhëzuesit ndërkombëtarë për lirinë dhe të drejtën për tubime.
3. Kërkesat e njoftimit për tubime të thjeshtohen, informacionet e kërkuara të reduktohen, të jenë relevante për tubimet paqësore dhe të mos jenë penguese.
4. Të gjitha ligjet, rregulloret, politikat, vendimet dhe informacionet e tjera që lidhen me ushtrimin e lirisë së tubimit paqësor duhet të jenë në dispozicion të publikut dhe lehtësisht të aksesueshme.
5. Ligji për tubimet duhet të ofrojë sqarime dhe udhëzime mbi procesin e apelimit ndaj vendimeve të autoriteteve shtetërore lidhur me kufizimet e mundshme të tubimeve.
6. Komunikimet ndërmjet institucioneve përgjegjëse që janë të përfshira në faza të ndryshme të procesit të mundësimit të tubimeve dhe organizatorëve të saj, duhet të rregullohen përmes procedurave ligjore që janë të aksesueshme për publikun.
7. Të bëhet unifikimi i masave ndëshkuese për organizatorët dhe pjesëmarrësit në tubime në Kodin Penal dhe Ligjin për Tubimet, në përputhje me standardet ndërkombëtare.